



## **AKT THEMELIMI**

### **I**

## **PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**

Ortaku i vetëm Themelues: Philip Morris International Management SA, një shoqëri e krijuar dhe e organizuar në bazë të Legjislacionit zviceran, selia e regjistruar e së cilës ndodhet në adresën Avenue de Cour 107, CH-1001 Lausanne (Lozanë), Zvicër.

### **Neni 1**

#### **Emërtimi dhe Selia**

- 1.1 “Philip Morris Albania” shpk (më poshtë “Shoqëria”) krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.
- 1.2 Selia e e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në adresën Rr. “Donika Kastrioti” EGT Tower, pallati 11/1, Shkalla 1, Kati i dytë, Tiranë.

### **Neni 2**

#### **Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

- 2.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë vijon:
  - a) Blerje, shitje, eksport dhe import i produkteve të duhanit dhe marketingu e tregtimi i pajisjeve dhe materialeve,
  - b) Aktivitet marketingu, reklamimi dhe tregtimi.

### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

- 3.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një afat kohor të pacaktuar.

### **Neni 4**

#### **Kapitali Themeltar**

- 4.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 29,000,000 lekë i ndarë në 29,000 aksione me një vlerë prej 1,000 (njëmijë) lekë secili.

**Neni 5**  
**Organet e Shoqërisë**

Shoqëria do të ketë dy organe, Administratorin e Përgjithshëm dhe Ortakun e Vetëm Themelues (më poshtë "Ortaku").

**Neni 6**  
**Ortaku**

- 6.1 Ortaku është Philip Morris International Management SA, një shoqëri e krijuar dhe e organizuar sipas legjislacionit zviceran, selia e regjistruar e së cilës ndodhet në adresën Avenue de Cour 107, CH-1001 Lausanne, Zvicër.

**Neni 7**  
**Administratori i Përgjithshëm**

- 7.1 Shoqëria menaxhohet dhe drejtohet nga Administratori i Përgjithshëm.
- 7.2 Z. Octavian Ioan Goga, shtetas rumun, lindur në Beius, Rumani më 28.06.1967, me banim në 142A, Gheorghe Ionescu Sisesti, Sector 1, Bukuresht, Rumani është emëruar nga Statuti i kësaj Shoqërie si Administrator i parë i Përgjithshëm i saj, dhe do të ushtrojë këtë funksion deri kur do të emërohet rregullisht një Administrator tjetër i Përgjithshëm.

**Neni 8**  
**Dispozita të fundit**

- 8.1 Veprimtaria e Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 8.2 Ky Akt Themelimi është bazuar në dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Ky Akt Themelimi nënshkruhet më 25 Shtator 2006, në tre (3) kopje.

**PHILIP MORRIS INTERNATIONAL MANAGEMENT SA**

Emri  
Titulli

Emri  
Titulli

**STATUT**  
**I**  
**“PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK”**

**Neni 1**  
**Emërtimi dhe Selia e Shoqërisë**

- 1.1 “Philip Morris Albania shpk” (më poshtë “Shoqëria”) krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin shqiptar dhe sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në këtë Statut.
- 1.2 Selia e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga “Donika Kastrioti” Kulla EGT, Pallati 11/1, Shkalla 1, Kati i dytë, Tiranë.

**Neni 2**  
**Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

- 2.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:
  - a) Blerje, shitje, import dhe eksport i produkteve të duhanit dhe marketingu e tregtimi i pajisjeve dhe materialeve; dhe
  - b) Aktivitet e marketingut, të reklamimit dhe të tregtimit.

**Neni 3**  
**Afati i Shoqërisë**

- 3.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë për një afat kohor të pacaktuar.

**Neni 4**  
**Kapitali themeltar**

- 4.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 29.000.000 lekë i ndarë në 29.000 aksione me një vlerë prej 1.000 lekë secila. Aksionet janë tërësisht të likuiduara në kesh.

**Neni 5**  
**Zmadhimi i kapitalit themeltar**

- 5.1 Zmadhimi i kapitalit themeltar mund të bëhet me kontribute në kesh ose në natyrë.

## **Neni 6** **Transferimi i aksioneve**

Aksionet mund të transferohen tek të tretët me vendim të ortakut të vetëm (më poshtë "Ortaku")

## **Neni 7** **Organet e Shoqërisë**

7.1 Shoqëria do të ketë dy organe, Administratorin e Përgjithshëm dhe Ortakun.

## **Neni 8** **Ortaku**

8.1 Ortaku ka të drejtë të:

- a) ndryshojë Statutin;
- b) miratojë planin vjetor të biznesit, programin vjetor të punës, raportin kontabël dhe financiar të Shoqërisë, si dhe bilancin;
- c) emërojë dhe shkarkojë Administratorin e Përgjithshëm dhe të caktojë pagën e tij;
- d) emetojë aksionet e reja;
- e) zmadhojë ose të zvogëlojë kapitalin themeltar;
- f) shpërndajë fitimin dhe të mbulojë humbjet;
- g) shpërndajë Shoqërinë;
- h) emërojë një ose disa kontrollorë (auditorë);
- i) mbikqyrë aktivitetet e shoqërisë; dhe
- j) shndërrojë Shoqërinë në një formë tjetër në përputhje me ligjin shqiptar.

## **Neni 9** **Administratori i Përgjithshëm**

9.1 Shoqëria menaxhohet dhe drejtohet nga Administratori i Përgjithshëm

9.2 Z. Octavian Ioan Goga shtetas rumun, lindur në Beius, Rumani, më 28.06.1967, me banim në 142A, Gheorghe Ionescu Sisesti, Sector 1, Bukuresht, Rumani, është emëruar nga ky Statut si Administrator i parë Përgjithshëm i Shoqërisë. Administratori i Përgjithshëm do të qëndrojë në këtë detyrë derisa të emërohet rregullisht një Administrator tjetër i Përgjithshëm.

9.3 Administratori i Përgjithshëm do të ndjekë e zbatojë politikën dhe vendimet e Ortakut, do të përfaqësojë Shoqërinë brenda caqeve të kompetencave të tij/saj, duke përfshirë edhe atë të parashikuar në pikën 10.1, dhe do të jetë ligjërisht përgjegjës për aktivitetet e Shoqërisë.

9.4 Administratori i Përgjithshëm do të menaxhojë dhe drejtojë veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë.

9.5 Administratori i Përgjithshëm do të sigurojë që menaxhimi i Shoqërisë të bëhet në mënyrë të ligjshme dhe në interes të Shoqërisë.

9.6 Administratori i Përgjithshëm do të hartojë të gjitha vendimet që miratohen nga Ortaku.

9.7 Administratori i Përgjithshëm, me pëlqimin me shkrim të Ortakut, mund të delegojë përkohësisht të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij tek një person tjetër.

#### **Neni 10**

##### **Të drejtat e nënshkrimit**

10.1 Cdo dy nga personat e mëposhtëm: Menaxheri i Përgjithshëm, Znj. Sanja Fabrio, me shtetësi kroate, e lindur në Osijek, Kroaci, më 11.01.1966, me banim në Ferencica 49, 10000 Zagreb, Kroaci; Z. Goran Hrzic, me shtetësi kroate, lindur në Beirut, Liban, më 09.03.1964, me banim në Trzna 3/a, 10000 Zagreb, Kroaci; Z. Jure Samardzic, me shtetësi kanadeze, lindur në Sinj, Kroaci, më 10.10.1963, me banim në Chemin de la Treille 5a, 1297 Founex, Zvicër; dhe Merita Lamllari, me shtetësi shqiptare, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 03.03.1973, me banim në Rr. Mujo Ulqinaku, Pall i Ri, Shkalla 2, Ap. 32, Shqipëri, autorizohen të lidhin marrëveshje dhe të nënshkruajnë në emër dhe për llogari të Shoqërinë.

#### **Neni 11**

##### **Emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar**

11.1 Ortaku mund të emërojë një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar "Për Shoqëritë Tregtare"

#### **Neni 12**

##### **Kontabilizimi dhe Kontrolli financiar**

12.1 Sistemi financiar dhe kontabël i Shoqërisë do të zbatojë të gjitha kërkesat e sistemit ligjor shqiptar financiar dhe kontabël.

#### **Neni 13**

##### **Dispozita të fundit**

13.1 Veprimtaria e Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Statut nënshkruhet më 25 Shtator 2006 në katër (4) kopje.

PHILIP MORRIS INTERNATIONAL MANAGEMENT SA

Emri:  
Titulli:

Emri:  
Titulli:

Përkthyer nga

Vera Batalli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË

Nr. 6906 Rep.

Nr. \_\_\_\_\_ Kol.



VËRTETIM

Vërtetohet firma e znj. Vera Batalli, njohur prej meje si përkthyesë e Anglishtes, e cila më deklaroi se përktheu nga Anglishtja në Shqip dokumentin bashkëngjitur njësoj me origjinalin dhe e firmosi atë sipas rregullave.

Tiranë 20/10/2006

NOTERE

NOTE:  
Mimosa Saa  
TIRANË



# STATUT

i

Philip Morris International Managmenet SA  
(Philip Morris International Management AG)  
(Philip Morris International Management Ltd)

## **I. EMËRTIMI, SELIA, KOHËZGJATJA DHE QËLLIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 1 Emërtimi, selia, vendndodhja, dhe kohëzgjatja**

Ekziston një shoqëri anonime, me emërtimin Philip Morris International Management SA (Philip Morris International Management AG, Philip Morris International Management Ltd), e cila rregullohet nga ky Statut, si dhe nga dispozitat e Titullit XXVI të Kodit të Detyrimeve. Selia e shoqërisë ndodhet në Lozanë (Lausanne), Kantoni i Vosë (Vaud).

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.

### **Neni 2 Qëllimi**

Shoqëria ka për qëllim:

- ofrimin e të gjitha shërbimeve që lidhen vecanërisht me organizim dhe drejtim ndërmarrjesh, dhe;
- prodhimin, zhvillimin, tregtimin në çfarëdo forme (blerje, shitje, eksportim, importim dhe përfaqësim) të mallrave të çfarëdo natyre.

Për pasojë, shoqëria, si në Zvicër ashtu dhe jashtë saj, mund të ndërmarrë këto hapa:

- të krijojë degë dhe filiale,
- të marrë, cedojë dhe menaxhojë pjesëmarrjet (aksionet) në ndërmarrje të çdo natyre, dhe;
- kryerja e çdo veprimtarie me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, kryerja e çdo akti dhe e çdo operacioni financiar dhe tregtar, vecanërisht dhënia e huave dhe e garancive në favor të aksionerëve, degëve ose të të tretëve nëse një gjë e tillë favorizon interesat e tyre.

## **II. KAPITALI THEMELTAR, AKSIONET DHE TRANSFERIMET**

### Neni 3 Kapitali themeltar, aksionet

Kapitali themeltar është 10,746,000 CHF (franga zvicerane). Ai është i ndarë në 10,746 aksione nominale me një vlerë prej 1000 CHF, secili i shlyer tërësisht.

Shoqëria mund të emetojë certifikata dhe tituj për një numër të dhënë aksionesh. Aksionet nominale mund të shndërrohen në aksione në bursë si dhe e kundërta.

### Neni 3a Kontributet në natyrë, dhe rimarrja e sendeve

Kontributet në shlyerjen e Kapitalit themeltar kryen në natyrë. Jnë të përbërë nga tërësia e aktivitetit dhe pasivitetit të filialit të shoqërisë Philip Morris SA, me seli në Eilmington, Delaëare (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), në përputhje me kontratën mbi kontributet në natyrë dhe mbi rimarrjen e sendeve.

Filiali në fjalë është regjistruar në Regjistrin Tregtar në Lozanë (Lausanne) me emërtimin Philip Morris SA, Wilmington, Delaware filial i Lozanës. Vendndodhja e saj është 4, chemin de Brillancourt, 1006 Lausanne.

Sipas kontratës mbi kontributet në natyrë dhe rimarrjen e sendeve, që mban datën 23 Nëntor 1998, vlera e saj është 10,746,261 CHF. Kjo shumë përfaqëson mbetjen e tërësisë së aktivëve me një vlerë prej 165,092,990 CHF, mbi tërësinë e pasivitetit prej 154,346,729 CHF.

Shoqëria që formohet blen pasivin të shënuar në bilancin e rimarrjeve, si dhe ato që kanë origjinën e tyre në kuadrin e aktivitetit tregtar të përditshëm të së kaluarës së kontribuesit në natyrë dhe që janë të një rëndësie më të vogël nëse merren vecanërisht ose edhe të grupuar, pavarësisht se nuk janë të shënuar në bilancin e sipërpërmendur. Ajo blen gjithashtu të gjitha detyrimet fiskale që rëndojnë mbi filialin dhe që kanë origjinën e tyre para datës së ekzekutimit të kësaj marrëveshjeje.

Është rënë dakort shprehimisht që shoqëria që formohet nuk do të rimarrë asnjë pasiv, qoftë i ditur ose jo, i mundshëm ose i një natyre tjetër, përveç atij që është përmendur në paragrafin pararendës.

Në bazë të kontributit të sipërpërmendur, shoqëria emeton 10,746 aksione me një vlerë nominale prej 1000 CHF secila, të shlyera tërësisht, ku shoqëria Philip Morris Europe SA Eilmington (Delaware), Ian Bryson dhe Jacques Philipona do të marrin 10,744, një aksion dhe një aksion respektivisht. Pjesa e mbetur me një shumë prej 261 CHF do t'i mbetet shoqërisë në formë huaje nga shoqëria Philip Morris SA, Wilmington (Delaware).

### Neni 4 Regjistri i aksioneve, aprovimi i transfertës

Shoqëria mban një regjistër të aksioneve në të cilin shënohen emrat si dhe adresat e pronarëve dhe të përdoruesve të aksioneve nominale. Shënimi në regjistrin e aksioneve



kryhet vetëm me dëftimin e një dokumenti që vërteton blerjen e titullit të pronësisë ose konstituimin e një uzufukti. Kur shoqëria ka emetuar tituj ose certifikata, ajo është e detyruar të tregojë shënimin mbi titullin respektivisht në certifikatë.

Konsiderohet si aksioner ose si përdorues kundrejt shoqërisë vetëm ata persona që janë regjistruar në regjistrin e aksioneve.

Aksionet nominale nuk mund të transferohen përveçse me aprovimin e Këshillit Administrativ. Ky kufizim vlen gjithashtu për konstituimin e uzufuktit.

Këshilli Administrativ mund të mos pranojë regjistrimin në regjistrin e aksioneve pa motivim në dy raste:

1. Nëse shoqëria i ofron shitësit të aksioneve që t'i rimarrë ato për logari t'ëvet, për llogari të aksionerëve të tjerë ose për llogari të të tretëve, me vlerën reale në castin e kërkesës për aprovim transferte; ose
2. Nëse blerësi i aksioneve nuk deklaron shprehimisht që i rimerr në emër të vet dhe për llogari të tij.

Këshilli Administrativ mund gjithashtu të mohojë regjistrimin në Regjistrin e aksioneve duke paraqitur një motiv të drejtë. Konsiderohen si motive të drejtë, vecanërisht rastet e mëposhtëm:

1. Kur blerësi i aksioneve ushtron drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë një aktivitet që hyn në konkurrencë ose dëmton shoqërinë;
2. Kur transferimi i aksioneve ndryshon përbërjen e rrethit të aksionerëve në një mënyrë të tillë që komprometon qëllimin e shoqërisë ose pavarësinë ekonomike të saj.

Nëse aksionet janë përftuar me anë të trashëgimisë, pjesëtimit të trashëgimisë, sipas regjimit martesor ose nëpërmjet një procedure ekzekutimi të detyrueshme, shoqëria mund të mos japë aprovim vetëm nëse ajo i ofron blerësit aksione që t'i rimarrë me vlerën e tyre reale.

Këshilli Administrativ, pasi të ketë dëgjuar personin e interesuar, mund të fshijë shënimet në regjistrin e aksioneve në rast se këto shënime janë bërë mbi bazën e informative jo të vërteta të dhëna nga blerësi. Ky i fundit duhet të informohet menjëherë.

### III. ORGANET

#### Neni 5 Organet

Organet e shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme

- b) Këshilli Administrativ
- c) Organi i Mbikëqyrjes

#### **a) Asambleja e Përgjithshme**

#### **Neni 6 Atributet e patjetërsueshme të Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i shoqërisë. Ajo ka të drejtën e patjetërsueshme të:

1. adoptojë dhe të ndryshojë Statutin;
2. të emërojë anëtarët e Këshillit Administrativ dhe të Organit i Mbikëqyrjes;
3. të aprovojë raportin vjetor dhe llogaritë e grupit;
4. të aprovojë llogaritë vjetore dhe të përcaktojë përdorimin e beneficeve që rezultojnë nga bilanci, në mënyrë të vecantë të fiksojë dividendët dhe përqindjet për anëtarët e Këshillit Administrativ;
5. të lirojë nga cdo detyrim anëtarët e Këshillit Administrativ;
6. të marrë të gjitha vendimet që i përkasin në bazë të ligjeve dhe Statutit.

#### **Neni 7 Thirrja, e drejta e shënimit të një objekti në rend të ditës, Asambleja e Përgjithshme si dhe Asamblesë së Jashtëzakonshme**

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Këshilli Administrativ, nga likuiduesit, ose nëse është e nevojshme, nga Organi i Mbikëqyrjes. Këshilli Administrativ thërret gjithashtu Asamblesë të Përgjithshme me anë të një kërkesë të hartuar nga aksionerët që përfaqësojnë të paktën një të dhjetën e Kapitalit Themeltar, duke përcaktuar objektet e diskutimit si dhe propozimet.

Asambleja e Përgjithshme e zakonshme zhvillohet cdo vit, brenda gjashtë muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar. Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme mund të thirret aq shpesh sa shfaqet e nevojshme.

#### **Neni 8 Mënyra e thirrjes**

Thirrja e Asamblesë së përgjithshme të zakonshme si dhe asaj të Jashtëzakonshme bëhet me shkrim, dhe u drejtohet në adresat e aksionerëve dhe përdoruesve të aksioneve të shënuar në regjistrin e aksioneve.

#### **Neni 9 Afati i thirrjes, dokumentat e nevojshëm**

Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën njëzet ditë para datës së mbledhjes. Në letrën e thirrjes përcaktohen objektet që janë shënuar në rend të ditës si dhe propozimet e Këshillit Administrativ dhe, në rast se nuk ka propozime nga Këshilli Administrativ, nga aksionerët.

Asnjë vendim nuk mund të merret mbi objekte që nuk janë shënuar në mënyrë të rregullt në rend të ditës, me përjashtim të propozimit për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme të Jashtëzakonshme dhe atij për të krijuar një kontroll të vecantë. Nuk nevojitet thirrja para kohe as e propozimeve që hyjnë në kuadrin e objekteve të shënuar në rend të ditës, as e vendimeve që nuk duhet të vijohen nga një votim.

#### **Neni 10 Asambleja universale**

Pronarët ose përfaqësuesit e tërësisë së aksioneve mund të mbajnë, nëse nuk ka kundërshtim, një Asamble të Përgjithshme pa ndjekur format e parashikuara për thirrjen e saj. Për aq kohë sa do të jenë të pranishëm të gjithë, kjo mbledhje gëzon të drejtën të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi të gjitha objektet që i përkasin kompetencave të saj.

#### **Neni 11 E drejta e votës, përfaqësimi**

Cdo aksioner jep të drejtën për të patur një votë.

Aksionerët mund të përfaqësohen pranë Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet një prokure të shkruar. Nuk është e nevojshme që përfaqësuesi të ketë cilësinë e aksionerit.

#### **Neni 12 Presidenca, vendimet, proces-verbali**

Presidenti i Këshillit Administrativ kryeson Asamblenë e Përgjithshme. Në rast mungese, zëvendës-presidenti i Këshillit Administrativ cakton presidentin. Presidenti cakton një hartues të proces-verbalit, i cili nuk është e domosdoshme të jetë aksioner.

Vendimet merren me shumicën absolute të aksioneve të përfaqësuarara. Përjashtim bën zbatimi i dispozitave të detyrueshme ligjore dhe statutore që kërkojnë një shumicë të kualifikuar.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme mbahen në një proces-verbal. Proces-verbali firmoset nga presidenti dhe nga hartuesi i tij.

#### **b) Këshilli Administrativ**

#### **Neni 13 - Përbërja**

Drejtoria është e përbërë nga një ose disa anëtarë.

#### **Neni 14 – Kohëzgjatja e funksioneve, organizimi**

Anëtarët e Këshillit Administrativ janë zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme për një vit, duke filluar nga dita e zgjedhjes së tyre dhe mbaron ditën e mbledhjes së Asamblesë së përgjithshme të zakonshme pasardhëse. U rezervohet e drejta e orëheqjes dhe e revokimit paraprak. Anëtarët e rinj përfundojnë kohëzgjatjen e funksioneve të anëtarëve që zëvendësojnë.

Këshilli Administrativ zgjedh vet anëtarët e tij. Ai cakton Presidentin dhe sekretarin. Nuk është e nevojshme që sekretari të jetë anëtar i Këshillit Administrativ.

#### Neni 15 – Atributet

Këshilli Administrativ menaxhon punët e shoqërisë deri në masën që nuk e ka deleguar.

Ai ka atributet e mëposhtme, të cilat janë të patransmetueshme dhe të patjetërsueshme:

1. të ushtrojë drejtimin e lartë të shoqërisë dhe të vendosë udhëzimet e nevojshme;
2. të vendosë mënyrën e organizimit;
3. të fiksojë parimet e kontabilitetit dhe të kontrolloit financiar si dhe planin financiar për aq sa ky i fundit të jetë i nevojshëm për menaxhimin e shoqërisë;
4. të emërojë dhe të revokojë personat e ngarkuar me menaxhimin dhe me përfaqësimin;
5. të ushtrojë mbikëqyrjen e lartë mbi personat e ngarkuar me menaxhimin për të siguruar vecanërisht që ato të respektojnë ligjin, statutin, rregullat si dhe udhëzimet e dhëna;
6. të paraqes raportin vjetor, të pregatisë asamblenë e përgjithshme dhe të ekzekutojë vendimet e tij;
7. të informojë gjyqtarin në rast mbingarkese borxhi.

Këshilli Administrativ mund të delegojë menaxhimin e shoqërisë, në kuadrin e dispozitave ligjore, drejt një ose disa anëtarëve ose të tretëve në përputhje me rregullin e organizimit.

Kompetencat e anëtarëve të Këshillit Administrativ për të përfaqësuar shoqërinë janë në përputhje me shënimin e bërë në regjistrin tregtar.

#### Neni 16 – Thirrja, vendimet, proces-verbali

Këshilli Administrativ thirret nga presidenti i saj aq herë që një gjë e tillë paraqitet e nevojshme. Presidenti duhet gjithashtu të thërrasë Këshillin Administrativ kur një anëtar i saj ka bërë kërkesë në të cilën të pasqyrohen dhe motivet.

Vendimet e Këshillit Administrativ merren me shumicën e votave. Në rast votash të barabarta, ajo e Presidentit është vendimtare.

Vendimet e Këshillit Administrativ mbahen në një proces-verbal të firmosur nga Presidenti eh Sekretari.

#### Neni 17 – Vendimet e marra pa diskutim paraprak

Vendimet e Këshillit Administrativ mund të merren gjithashtu pa diskutim paraprak, përveç rastit kur diskutimi kërkohet nga një prej anëtarëve të Këshillit.

Këshilli Administrativ parashikon në rregulloren e organizimit kërkesat që lidhen me formën e shkruar të parashikuar në nenet 16 dhe 17 të këtij Statuti.

### **c) Organi i Mbikëqyrjes**

#### **Neni 18 – Kohëzgjatja e funksionit**

Asambleja e Përgjithshme zgjedh si anëtar të Organit të Mbikëqyrjes një ose disa mbikëqyrës.

Organi i Mbikëqyrjes është zgjedhur për një afat njëvjeçar. Funksioni fillon ditën e zgjedhjes së tij dhe mbaron ditën e Asamblesë së Përgjithshme të zakonshme pasardhëse.

#### **Neni 19 – Detyrimi për të verifikuar dhe paraqitur raportin.**

Organi i Mbikëqyrjes përmbush detyrën e tij për të verifikuar dhe paraqitur raportin në përputhje me dispozitat e Kodit të Detyrimeve.

#### **Neni 20 – Kontrolle të vecanta, mbikëqyrje të ndërmjetme.**

Këshilli Administrativ mund të ngarkojë në cdo kohë Organin e Mbikëqyrjes që të ndërmarrë kontrolle të vecanta, vecanërisht mbikëqyrje të ndërmjetme, si dhe t'i paraqesë atij një raport.

## **IV. USHTRIMI I VEPRIMTARISË SHOQËRORE, SHPËRNDARJA E FITIMEVE DHE KOMUNIKIMET.**

#### **Neni 21 – Ushtrimi i veprimtarisë shoqërore, raporti i menaxhimit dhe mbikëqyrja.**

Veprimtaria shoqërore përputhet me vitin civil kalendarik. Përrjashtim bën veprimtaria shoqërore që fillon më një korrik dy mijë e pesë dhe përfundon më tridhjetë e një dhjetor dymijë e pesë. Llogaritë duhet të mbyllen në fund të cdo ushtrimi të veprimtarisë shoqërore.

Raporti i menaxhimit dhe raporti i mbikëqyrjes vihen në dispozicion të aksionerëve pranë selisë së shoqërisë, jo më vonë se 20 ditë para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të zakonshme. Ato u jepen pa asnjë afat aksionerëve që i kërkojnë.

#### **Neni 22 – Llogaritja dhe përdorimi i fitimeve të nxjerra gjatë ushtrimit vjetor.**

Fitimi i nxjerrë gjatë ushtrimit vjetor llogaritet mbi bazën e bilancin kontabël dhe të llogarisë së humbjeve dhe fitimeve në përputhje me dispozitat ligjore.

Rezerva e përgjithshme përbëhet në përputhje me nenin 671 të Kodit të Detyrimeve.

Fitimi vihet ne dispozicion të Asamblesë së Përgjithshme që mund të vendosë të formojë rezerva të reja. Asambleja e Përgjithshme ka kompetencën përjashtimore të vendosë për përdorimin e rezervave shtesë.

**Neni 23 – Komunikimet, organi i publikimit.**

Komunikimet e shoqërisë bëhen me shkrim në adresat e aksionerëve dhe të përdoruseve të shënuar në regjistrin e aksioneve. Nëse ligji nuk parashikon ndryshe në mënyrë detyruese, Këshilli Administrativ mund gjithashtu të bëjë komunikime me anë të një publikimi të vetëm në Fletoren Zyrtare Zvicerane të Tregtisë.

Organi i publikimit të shoqërisë është Fletorja Zyrtare Zvicerane e Tregtisë.

STATUT I MODIFIKUAR nga Asambleja e Përgjithshme më datë 26 Qershor 2006.

E vërteton :

(vula – Laurent Besso noter)

(firma)

**STATUT KONFORM**

me atë të bashkangjitur me originalin nr. 2,374,

e vërteton:

(Vula) (Firma)

Nënshkruesi vërteton se statuti është konform me atë që është depozituar në Regjistrin Tregtar të kantonit të Vaud-së.

Moudon, më 26.09.2006

Punonjësi: (Firma)

(Vula)

Pagesa e pullës e kryer